



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

BORDI DREJTUES

Nr. 504 / Prot.
21

Tiranë, më 30.12.2024

VENDIM

Nr. 12, datë 30.12.2024

Bazuar në ligjin nr.17/2018 “Për statistikat zyrtare”, neni 20, shkronja “ç”, me propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Statistikave Rajonale, Bordi Drejtues i Institutit të Statistikave në mbledhjen e datës 19.09.2024.

VENDOSI:

1. Në Rregulloren e Brendshme të Zyrave Rajonale Statistike, të bëhen ndryshimet e mëposhtme.
2. Në nenin 1 pika 2, pas fjalëve “...Vendim të Bordit Drejtues...,” shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:
“*Rregullorja e INSTAT miratuar me vendimin nr. 5, datë 09.07.2019 të Bordit Drejtues ndryshuar me vendimin nr. 7, datë 04.07.2022, vendimin nr. 5 datë 08.07.2024 të Bordit Drejtues dhe vendimin nr. 7 datë 23.09.2024 të Bordit Drejtues*” dhe hiqet “... nr.208/20, datë 09.07.2019”.
3. Në nenin 2 pas fjalëve “zyrave rajonale statistike” shtohet “_____”.
4. Neni 5 ndryshon me përmbajtjen si vijon:
“*Përgjegjësitë e tyre mbështeten në ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, Programin e Statistikave Zyrtare, Planin operacional vjetor të INSTAT dhe në aktet administrative të nxjerra nga organet drejtuese të INSTAT-it*”.
5. Në nenin 6 pika 2, fjala “numër” zëvendësohet me “Nr” dhe pas fjalëve “... Republikës së Shqipërisë ...” shtohet fjalët “*Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 127/2018, “Për*

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave (INSTAT)”.

6. Në nenin 6 pika 3, fjala “Stafi” zëvendësohet me fjalën “Punonjësi” dhe shtohet paragrafi me përmbajtjen si më poshtë:

“Specialistët që sipas paraqitjes skematike të strukturës së Drejtorisë Statistikore Rajonale dhe Gjeoinformacionit ushtrojnë aktivitetet në nivel bashkie, varen nga zyrat rajonale përkatëse dhe mbulojnë aktivitetet e mbledhjes së të dhënave sipas shpërndarjes të anketave specifike në terren”.

7. Në nenin 6 pika 5 fjala “stafit” zëvendësohet me fjalën “punonjësit” dhe paraqitja skematike e strukturës dhe përbërjes së DSRGJ ndryshon si vijon:



8. Në nenin 7 shkronja “e”, pas fjalës “Vendos” hiqet lidhësja “dhe” .
9. Në nenin 7 shkronja “f”, emërtimi “Ministrisë së Financave dhe ekonomisë” ndryshohet në “Ministrisë së Financave”.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
INSTITUTI I STATISTIKAVE

10. Në titullin e nenit 9 fjala “stafi” zëvendësohet me fjalën “punonjësit”.
11. Në nenin 10 pika 1 shkronja “f”, në fjalinë e parë togfjalëshi “mbi stafin” zëvendësohet me fjalën “specialistët”.
12. Në nenin 10 pika 1 shkronja “f”, në fjalinë e fundit fjala “stafi” zëvendësohet me fjalën “punonjësit”.
13. Në nenin 13, përmbajtja e pikës “j” ndryshon si vijon:
“Hartimin e raporteve financiare mujore të raportimit të buxhetit dhe dërgimin e tyre zyrtarisht në INSTAT (situacion shpenzimesh)” dhe pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k” me përmbajtjen si vijon :
“Hartimin e raporteve periodike të detajuara të monitorimit të buxhetit 4 mujore dhe dërgimin e tyre zyrtarisht në INSTAT”.
14. Në titullin e Kreut III, fjala “stafi” zëvendësohet me fjalën “punonjësit”.
15. Në nenin 14 fjalia e dytë e paragrafit të parë ndryshohet si vijon:
“Marrëdhëniet e punës së tyre rregullohen sipas dispozitave të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”.
16. Në nenin 16 pika 2, pas fjalëve “Kodin e Etikës së INSTAT” shtohet linku si më poshtë vijon:
“(https://www.instat.gov.al/media/8421/kodi-etikes-2019.pdf)”.
17. Në nenin 20 pika 2 ndryshon me përmbajtjen si vijon:
“2. Punonjësit e zyrës rajonale të INTSTAT duhet të respektojnë orarin zyrtar të detyrueshëm të punës, prej orës 9:30 - 15:30, nga e hëna të enjte dhe 9:30 - 13:00 të premten, sipas përcaktimit me vendim të Këshillit të Ministrave për kohëzgjatjen e punës në administratën publike. Ata duhet ta përdorin me efektivitet kohën e punës për realizimin e detyrave të ngarkuara”.
18. Në nenin 20 pika 8, pas fjalëve “përdorimin efektiv të kohës së punës” shtohet togfjalëshi
“me instrumentat që kanë në dispozicion”.
19. Në Nenin 21 pika 2 ndryshon me përmbajtjen si vijon:

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

" 2. Në rast të mungesave për arsye shëndetësore, nëpunësi duhet të njoftojë brenda orës 9.30 të asaj dite eprorin direkt dhe për dijeni Drejtorin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve, si dhe Sektorin e Burimeve njerëzore. Kohëzgjatja e mungesës i njoftohet eprorit direkt menjëherë pas tërheqjes së raportit mjekësor."

20. Në nenin 22, shkronja "a" në nënpikën "- lejet dhe pushimet" shtohet fjalia si më poshtë vijon:

"referuar Rregullore e Brendshme e Institutit të Statistikave 2019 e përditësuar,
<https://www.instat.gov.al/media/14034/rregullore-e-brendshme-instat-e-ndryshuar-shtator-2024-19092024.pdf>."

21. Në nenin 25 pas titullit të nenit hiqet fjala "Dokumentimi".

22. Në seksionin "TË TJERA" titulli Neni "X" ndryshohet me titullin "Neni 26".

KRYETAR I BORDIT DREJTUES

Elsa Dhuli